



Ftesë për ofertë

Titulli: “Ofertë për Sigurimin e Parave në Kasafortë”

Data e hapjes për ofertim: 29 / 09/2022

Data e mbylljes për ofertim: 07 / 10 /2022

Institucioni Mikrofinanciar Agjencioni për financim në Kosovë –AFK, fton kompanitë e Sigurimit të interesuara të paraqesin ofertat për “Sigurimin e Parave në Kasafortë”, me këto karakteristika si në vijim:

1.Informata të përgjithshme:

- Sigurimi i parave në Arke
- Sigurimi i parave në Kasafortë
- Pjesa e Zbritshme në përqindje për Arkë
- Pjesa e Zbritshme në përqindje për Kasafortë
- Periudha e sigurimit 12 muaj

2.Kërkesat për ofertat financiare:

- Ju lutemi që ofertën tuaj ta dorëzoni tek zyrja e AFK-së në pajtim me specifikat e parashtruara në pikën 1 të këtij dokumenti.
- Të gjitha ofertat të dorëzohen në Euro, përfshirë TVSH-në, në të kundërtën në rast se çmimet dorëzohen pa e specifikuar TVSH-në, AFK do të konsiderojë se çmimet përfshijnë TVSH-në.

3.Kushtet e përgjithshme:

Oferta duhet të përmbaj informatat në vijim:

- Adresa e plotë dhe detajet kontraktuese të ofertuesit;
- Të përmbajë numrin e ofertës dhe datën e ofertës;
- Ofertën e specifikuar me çmime;
- Çdo faqe e ofertës duhet të vuloset dhe të nënshkruhet nga personi i autorizuar;
- Ofertës duhet t'i bashkangjitet Çertifikata e Regjistrimit të Biznesit dhe Çertifikata e numrit Unik (kopje).

4.Kushtet dhe rregullat e tenderit:

- Dokumentet duhet të vendosen në një zarf të mbyllur dhe të dorëzohen në zyret e AFK-së; AFK do të pranojë vetëm ofertat e juaja të mbyllura në zarf, dhe nuk do të konsideroj asnjë formë tjetër të aplikimit.
AFK nuk mban përgjegjësi për dëmtimin, humbjen apo mos pranimin e ofertave.
- Vlefshmëria e ofertës së paku një muaj.

Ofertat duhet të dërgohen të mbyllura në zarf me mbishkrimin "***Ofertë për Sigurimin e Parave***" në adresën e zyrës qendrore të AFK-së në Pejë : Rruga "Lidhja e Prizrenit Nr.1" 30 000.

Afati i fundit i pranimit të ofertave: 07 / 10 / 2022 ora 16:00.

AFK mbanë të drejtën e anulimit ose të ndryshimit të shpalljes në çdo kohë.